

VENDIM
Nr. 853, datë 24.12.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 327, DATË 27.4.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I LINJËS 110 kv, RRASHBULL-GOLEM-KAVAJË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 327, datë 27.4.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në pikën 3, vlera nga 967 956.8 (nëntëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtë pikë tetë) lekë, ndryshohet në 957 814.52 (nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e katërmëdhjetë pikë pesëdhjetë e dy) lekë.

b) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4. Vlera e përgjithshme e kompensimit dhe vlera e shpenzimeve për botimin në gazetë të përballohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., si subjekti kërkues i këtij shpronësimi, ndërsa shpenzimet procedurale, në shumën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga fondet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë."

c) Nënndarjet me nr. rendorë 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43 dhe 44, ndryshohen sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a. dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kavajë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E TË CILËVE PREKEN NGA DISA SHITESA DHE NDYSHIME NË VENDIMIN NR. 327, DATË 27.4.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I LINJËS 110 kv RRASHBULL-GOLEM-KAVAJË"

Nr. rendor në VKM-në nr. 327, datë 27.4.2016	Numri i shtyllës									
		Lloji i pasurisë	Emri	Atësia	Mbiemri	Nr. i pasurisë	Zona kadastrale	Sip. e shpronësimit për shtyllë (m ²) sipas VKM-së nr. 327, datë 27.4.2016	Çmimi lekë/m ²	Vlera e shpronësimit në lekë për shtyllë
FSHATI SEFERAJ										
36	36	Arë	Bashkëpronësi Familja Ajazi			503/1	3271	58.32	329	19,188.52
FSHATI TILAJ										
37	37	Arë	Bashkëpronësi Familja Shahu			423/2, 423/3	3600	77.33	329	25,443.03
38	38	Arë	Bashkpronësi Familja Tila			425/46	3600	47.33	329	15,573.02
FSHATI SEFERAJ										
39	39	Arë	Avni		Belba	508/20	3271	112.36	329	36,966.44
40	40	Arë	Bashkëpronësi Familja Çelçica			525/49	3271	112.36	329	36,966.44
41	41	Arë	Altin	Halil	Begeja	359/25	3271	40.56	329	13,344.24
42	31 A	Arë	Bashkëpronësi Familja Ajazi			358/8	3271	73.96	329	24,332.84
43	42	Arë	Bashkëpronësi Familja Çopa			357/8	3271	77.33	329	25,441.57
44	43	Arë	Bashkëpronësi Familja Ajazi			356/10	3271	34.33	329	11,294.57
Sipërfaqe totale për shpronësim (m ²)			633.89							
Shuma totale në lekë për			208.550.67							

shproněsim	
------------	--